



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Data _____.____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Pune

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kuman"

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Materiale për riparim rrugësh – 45210000-2, Punime riparimi rrugësh-45233142-6**

VLERA E FONDIT LIMIT: 36 222 194 (tridhjetë e gjashtë milion e dyqind e njezet e dy mijë e njeqind e nentdhjete e kater) lekë pa TVSH

Argumentimi i fondit limit: Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”, KLLFLST për llogaritjen e cmimit është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre në VKM nr.625 datë 15.07.2015 (ndryshuar me VKM-në nr.631 datë 26.10.2018) me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. (Dokumentuar me relacionin shpjegues të KLLFLST nr.269/3 datë 17.01.2025.

Arsyeja e përdorimit të procedurës së prokurimit: “E hapur” është sepse fondi limit është mbi kufirin e ulët monetar në sektorin klasik bazuar në Ligjin nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar nenin 42; në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 11 pika 1 dhe neni 47, 74, 77, si dhe në VKM nr.291 datë 15.5.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, kreu II pika 2/a.

Në bazë të nenit 21 pika 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenit 2 pika c dhe nenit 78 pika 2 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti/enti Kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar neni 83 pika 1 si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 30 pika 1. Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 26 i VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Këto kriterë janë vendosur për të vërtetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte. Gjithashtu këto kriterë janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e provës tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1.Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 7 dhe 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 14 pika 2 dhe 77 pika 1/a dhe 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; nenin 39 pika 6/b dhe nenin 88pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.Ky kriter vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1.Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 pika 3 e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe nenin 43 pika 2/b të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 e Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe në nenin 43 pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës konkretisht, Ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë nga OE pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojë raportet nëpërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 5 datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar nenit 29 të ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore" i ndryshuar: "*Çdo tatim-pagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatim-paguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë të Financave, në zbatim të këtij ligji*".

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 në zbatim të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetedeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar; Kreu V, Seksioni III, Neni 43 pika 6 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar si dhe sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar neni 4 pika 2/d. Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me

dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen eaktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.3 Kapaciteti teknik.

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme :

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, **Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse **pika 2.3.1/b** duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Akt i kolaudimit
- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;

- Situacion/faturë tatimore;
- Akt i kolaudimit
- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve të deklaruar në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 39 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm ose dyfishi i vlerës limit te kontrates që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:** Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë Autoritetin Kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021 e ndryshuar, parashikon se (pika 1): *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”*. (pika 3): *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. 65 Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht”*.

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave të mesiperme, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndërtimi”* e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP.1 A	Punime gjërmimi në tokë
2	NP.4 B	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39 pika 6/a të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: *”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga organet kompetente shtetërore”,* si dhe në klasifikimin e niveleve (gërmave) për punimet sipas natyrave respektive, të parashikuara në VKM Nr.42 date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Tedhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar neni 8 përcakton: *”Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, Autoriteti Kontraktor argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.*

Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme.

Kategoria NP-1 A (Punime gjërmimi në tokë)

- Konsiderohen gjërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Kategoria N.P-4 B (Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale).

- Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet nën nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

KATEGORITE E KËRKUARA JANË KËRKUAR NË BAZË TË ZERAVE DHE VLERAT E PUNIMEVE SI ME POSHTE:

KATEGORIA	Pershkrimi i kategorise sipas legjislacionit te fushes	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar per kategorin e respektive
<u>N.P. 1-A</u>	Punime gjurmimi në tokë	Punime gjurmim dheu Transport dheu	Niveli A (0-20 milion) lekë
<u>N.P-4 B</u>	(Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale).	Punime per shtresa çakulli, shtrese stabilizanti, shtrese binder.	Niveli B (21-50 milion) lekë

2.3.3.a. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi - 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder - 1 (një)

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e vlefshme
- Diploma
- CV
- Licence

Drejtimesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kritereve të VKM Nr. 42 date 16.01.2008 “i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit. Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori i shoqerise.

Operatorët ekonomik duhet të caktojë me anë të një dekaratë Drejtuesin Teknik të punimeve i cili duhet të jetë i përfshirë në license e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesin e kerkuar si me siper, emer/mbiemer, numrin dhe daten e certifikates, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar neni 77 pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39 pika 6 gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet endërtimit. Staf i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Inxhinieri i Ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventivë.

Inxhinieri Topograf/Gjeodet/Markshajder është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventivë.

2.3.3.b. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojë në listëpagesat e subjektit, punonjesit specialistë të kualifikuar, si më poshtë:

EMERTIMI	
Teknik të mesëm ndërtimi	(1 person)

Për punonjësin me profesionet si më sipër, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit, Operatorët Ekonomikë duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomes/certifikates së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetërore, të cilat regjistrohen në bazën e të dhënave të AKPA-së pranë Ministrisë së Financave (Institucioni përgjegjës për formimin profesional).

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzes/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
etj					

Për punonjësin e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës;
- Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara /akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”i ndryshuar si dhe dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e pikes **2.3.3.b** janë bazuar në nenin 77 pika 4 e Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 39 pika 6/c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.SH” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të

punimeve. **Tekniku i mesëm i ndërtimit** është i nevojshem për ndjekjen e realizimin e punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivave të punimeve duke siguruar keshtu kontrollin e cilesise se punimeve ne te gjitha fazat e projektit.

2.3.3.c. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR. **minimalisht** si më poshtë:

- Manovratore 3 (tre)
- Shofer 3 (tre)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me Urdhërin nr. 200 datë 16.5.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e kërkuar si me sipër, emer/mbiemer, numrin dhe datën e dëshmisë së aftësisë profesionale.*

**(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 e Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 39 pika 6/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)” të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqine minimale punëtore, te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit.

- **Manovratorët** janë të nevojshëm për manovrimin e mjeteve të rënda që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve. Bazuar në orët e punës që dalin nga zberthimi zë më zë i preventivit dhe afatit të punimeve rezultojnë të nevojshëm 3 manovratorë.

- **Shoferët** janë të nevojshëm për manovrimin e mjeteve (kamionave) që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve. Bazuar në orët e punës që dalin nga zberthimi zë më zë i preventivit, afatit të punimeve si dhe sasisë së materialeve që do të transportohen rezultojnë të nevojshëm 3 shoferë.

2.3.3.d. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **4 punëtore të thjeshtë ndërtimi**, për te cilët të paraqiten kontratat e punës si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimalisht për muajin e fundit kur jane pjese e stafit te shoqerise ose kur jane siguruar nga operatori

ekonomik me ane te marredhenies kontraktore per ekzekutimin e kontrates objekt prokurimi nuk kerkohej te figurojne ne listepagesat perkatese.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, ne perputhje me perqindjen dhe/ose natyren e pjesemarrjes ne pune, sherbim apo furnizim, te percaktuara ne aktmarrveshje.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojces 8 te DT. Dokumentat e kerkuara me sipër do te paraqiten referuar percaktimeve te nenit 26, pika 6, te VKM nr. 28, date 19.05.2021 i ndryshuar, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve ankimit, ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Për të percaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë llogaritur nepermjet analizave teknike nga anetaret e Njesise se Prokurimit me profil inxhinier ndertimi, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht Vendimit Nr. 216 date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar perinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Numri i punëtorëve është si rezultat i analizës teknike që kanë antarët e Njesise se Prokurimit me profil inxhinier, kane kryer llogarite perkatese.

2.3.3.e.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtoare prej minimalisht **13 (trembedhjetë) persona** të pasqyruar në listëpagesën e muajit e fundit.Për përmbushjen e këtij kushti operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve per muajin e fundit.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi per muajin e fundit.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike kjo pikë duhet te plotesohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të percaktuara në akt marrveshje).

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojces 8 te DT. Dokumentat e kerkuara me sipër do te paraqiten referuar percaktimeve te nenit 26, pika 6, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 i ndryshuar , perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve ankimit, ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatoreve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”. Numri i punonjësve është percaktuar bazuar në afatin, orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratën.Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për

Autoritetin Kontraktor. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për njëpunësim prej 15 punonjës është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë Autoritetit Kontraktor për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39 pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, sipas së cilës: "Autoriteti/enti Kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës".

2.4. Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Cope 2
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 15 ton	në pronësi ose me qira	Cope 1
Kamionçine me kapacitet mbajtes deri ne 3 ton	në pronësi ose me qira	Cope 1
Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Cope 1
Rimorkiator per transportimin emjeteve te renda me kapacitet min 20 ton	në pronësi ose me qira	Cope 1

Grejder	në pronësi ose me qira	Cope 1
Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Cope 1
Autobitumatriçe	në pronësi ose me qira	Cope 1
Rrul gome-cilinder	në pronësi ose me qira	Cope 1
Rrul cilinder – cilinder	në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobot uji	në pronësi ose me qira	Cope 1
Vibrator thellesie	në pronësi ose me qira	Cope 1
Bitoneri 500 liter	në pronësi ose me qira	Cope 1
Autovinç	në pronësi ose me qira	Cope 1
Kokore	në pronësi ose me qira	Cope 15
Jelek	në pronësi ose me qira	Cope 15
1 (nje) Njësi/Fabrikë prodhimi Asfaltobeton	në pronësi ose me qira ose me kontrate furnizimi	Jo me larg se 30 km
Kantier per prodhimi e inerteve	në pronësi ose me qira ose me kontrate furnizimi	Cope 1

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- b) Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit te vlefshme), duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerese e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, si kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese.

- d) Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimin te kontrates.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit dhe Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar ne procedura te shpallura fitues.

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **1 (një) Njësi/Fabrikë prodhimi Asfaltobetoni dhe 1 (nje) kantier per prodhimi e inertevenë pronësi ose me qera ose me Kontrate Furnizimi** (Kontrata Noteriale e Qerave/Furnizimit duhet te kete kohezgjatje per gjithë periudhen e realizimit te punimeve objekt kontrate), ku per permbushjen e ketij kushti duhet te paraqitet:

- Për Njësi/Fabrikë prodhimi Asfaltobetoni dhe kantierin për prodhimin e inertevenëse janë **në pronësi** duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton pronësinë (Çertifikate/plan vendosje/Kartele pasurie).
- Për Njësi/Fabrikë prodhimi Asfaltobetoni dhe kantierin për prodhimin e inerteve nëse janë **me qera** duhet të paraqesin: Kontratën noteriale të qerave/furnizimit në rast se fabrika/kantieri është me qera ose kontrate furnizimi.
- Në rast se Njësi/Fabrikë prodhimi Asfaltobetoni dhe kantieri për prodhimin e inerteve është në pronësi/me qera duhet të paraqitet edhe **Leja e mjedisit nga QKL** sipas ligjit ne fuqi.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike pikat e kriterit 2.4 duhet te plotesohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 39 pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të

mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Per fabriken e asfaltit eshte kerkuar qe te kete distance jo me shume se 30 km nga vendodhja e objektit per faktin qe binderi dhe asfalti te kene temperaturen e duhur gjate hedhjes ne objekt kjo ne bazë dhe të VKM 628 date 15.07.2015 (Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve).

Ky objekt parashikohet te zbatohet ne stinen e dimrit dhe nisur nga faktorët atmosferik marrja e asfaltit nga një distancë më e largët do të ndikonte në cilësinë dhe temperaturat optimale të nevojshme për hedhjen e tij në trupin e rrugës. Kantier per prodhimi e inerteve kerkohet per furnizimin e materialeve qe do te perdren per objektin e prokurimit sic jane shtresat rrugore, cakull dhe stabilizant.

2.5 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë, dhe mjedisit.

Për këtë duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- a) ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente (e vlefshme).
- b) ISO 45001:2018 (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë) ose ekuivalente (e vlefshme).

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike kjo pikë duhet të plotësohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas nenit 79 pika 1 e ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë” si dhe ne zbatim të nenit 44 pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Autoriteti Kontraktor gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikata e kërkuara janë në përputhje me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

ISO 9001:2015 është kërkuar me qëllim vërtetimin e efektivitetit dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së operatorit ekonomik, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove, duke bërë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 45001:2018 është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgatitjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor, ku veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve

2.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 6 (gjashtë) muaj kalendarike.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39 pika 3. Ky kriter vendoset me qëllim që të përcaktohet në mënyrë të qartë shpërndarja e fuqisë puntore dhe e mjeteve me anë të një grafiku punimesh.

2.7 Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6 të këtij neniku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26 pika 1 e VKM-së, nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Punimet objekt prokurimi, të cilat shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, bazohen në parashikimet e nenit 4, nenit 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenit 39 pika 2, të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike të këtij objekti prokurimi janë përcaktuar nga Komisioni i posacëm: **KLLFLST**, sipas materialit bashkëlidhur ne SPE.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË KËTIJ OBJEKTI PROKURIMI JANË PËRCAKTUAR NGA KLLFLST NË PROJEKT DHE SHPREHIN QARTE KERKESAT E AUTORITETIT KONTRAKTOR PËR CILËSINË E KRYERJES SË PUNIMEVE SIPAS MATERIALIT BASHKËLIDHUR NE SPE.

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të Autoritetit Kontraktor **nr.9 datë 24.01.2025**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: "**Riparimi i shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kuman**" me fond limit prej: **36 222 194 (tridhjetë e gjashtë milion e dyqind e njezet e dy mijë e njeqind e nentdhjete e kater) lekë pa TVSH**, lloji i procedurës: **E hapur**.

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

Argumentim: Anëtarët e NJ.P pranuan procesverbalin, preventivin dhe dokumentacionin teknik të dorëzuar nga Komisioni i posacëm: **KLLFLST (Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike)** i ngritur me Urdher të titullarit të Autoritetit Kontraktor **nr. 269 prot datë 16.01.2025**.

Preventivi është hartuar nga Studio "Angerba" & "Grama" sh.p.k dhe marre ne dorezim nga specialistet e fushës konkretisht nga KLLFLST me procesverbalin Nr. 269/1 prot date 17.01.2025. Specialistet e fushës konkretisht KLLFLST kane mbajtur procesverbalin nr. 269/2 prot datë 17.01.2025 si dhe relacionin shpjegues nr. 269/3 prot date 17.01.2025 ku shprehin qarte kërkesat e Autoritetit Kontraktor për cilësinë e kryerjes së punimeve.

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Nr	Nr.An.	Zeri i punes	Njesia	Sasia
	I	RIPARIMI I SHITESAVE SIPERFAQESORE TE RRUGES FASLLI SHURDHA,FSHATI KUMAN,B = 3 m,L = 605 ml		
1	3.89/b	Germim mak.shkar. ne mjet per skarifikim dhe kanal anesor	m ³	242
2	3.158/3a	Transport dheu auto 3 km	m ³	242
3	3.211	Shtrese çakelli 20 cm	m ²	484
4	3.212/b	Shtrese stabilizanti 10 cm	m ²	2,420
5	3.229/1	Shtrese binder 5 cm	m ²	1,815
	II	RIPARIMI I SHITESAVE SIPERFAQESORE TE RRUGES DANI XHAFJA,FSHATI KUMAN,B = 3 m;L = 250 ml		
1	3.89/b	Germim mak.shkar. ne mjet per skarifikim dhe kanal anesor	m ³	100
2	3.158/3a	Transport dheu auto 3 km	m ³	100
3	3.211	Shtrese çakelli 20 cm	m ²	200
4	3.212/b	Shtrese stabilizanti 10 cm	m ²	1,000
5	3.229/1	Shtrese binder 5 cm	m ²	750
6	3.243	Beton C 16/20 h=80 cm per uren kembesore (Mbeshteteset)	m ³	0.4
7	3.243	Beton C 16/20 h=80 cm per uren kembesore (Soleta)	m ³	0.8
8	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	0.071
9	2.166/1a	F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm	ton	0.131
10	2.182	Konstruksion metalik per uren kembesore	ton	0.25
	III	RIPARIMI I SHITESAVE SIPERFAQESORE TE RRUGES SYRRI BALLA,FSHATI KUMAN,B = 3 m;L = 268 ml		
1	3.89/b	Germim mak.shkar. ne mjet per skarifikim dhe kanal anesor	m ³	107
2	3.158/3a	Transport dheu auto 3 km	m ³	107
3	3.211	Shtrese çakelli 20 cm	m ²	214
4	3.212/b	Shtrese stabilizanti 10 cm	m ²	1,072
5	3.229/1	Shtrese binder 5 cm	m ²	804
	IV	RIPARIMI I SHITESAVE SIPERFAQESORE TE RRUGES KADRI PLAKA ,FSHATI VIDHISHTE,B = 3 m;L = 318 ml		
1	3.89/b	Germim mak.shkar. ne mjet per skarifikim dhe kanal anesor	m ³	127
2	3.158/3a	Transport dheu auto 3 km	m ³	127
3	3.211	Shtrese çakelli 20 cm	m ²	254

4	3.212/ b	Shtrese stabilizanti 10 cm	m ²	1,272
5	3.229/ 1	Shtrese binder 5 cm	m ²	954
	V	RIPARIMI I SHTRESAVE SIPERFAQESORE TE RRUGES NASIL KAÇELI ,FSHATI MARINEZ,B = 3 m;L = 1 253 ml		
1	3.89/b	Germim mak.shkar. ne mjet per skarifikim dhe kanal anesor	m ³	501
2	3.158/ 3a	Transport dheu auto 3 km	m ³	501
3	3.211	Shtrese çakelli 20 cm	m ²	1,002
4	3.212/ b	Shtrese stabilizanti 10 cm	m ²	5,012
5	3.229/ 1	Shtrese binder 5 cm	m ²	3,759
	VI	RIPARIMI I SHTRESAVE SIPERFAQESORE TE RRUGES KRONI PRIFTL,FSHATI MARINEZ,B = 3 m;L = 737 ml		
1	3.89/b	Germim mak.shkar. ne mjet per skarifikim dhe kanal anesor	m ³	295
2	3.158/ 3a	Transport dheu auto 3 km	m ³	295
3	3.183/ a	Shtrese zhavori per kunete 10cm.	m ²	240
4	3.243/ 1	Beton C16/20 per kunete	m ³	24
5	3.211	Shtrese çakelli 20 cm	m ²	590
6	3.212/ b	Shtrese stabilizanti 10 cm	m ²	2,948
7	3.229/ 1	Shtrese binder 5 cm	m ²	2,211
	VII	RIPARIMI I SHTRESAVE SIPERFAQESORE TE RRUGES BRENGAS,FSHATI LUAR,B = 3 m;L = 1 735 ml		
1	3.89/b	Germim mak.shkar. ne mjet per skarifikim dhe kanal anesor	m ³	694
2	3.158/ 3a	Transport dheu auto 3 km	m ³	694
3	3.211	Shtrese çakelli 20 cm	m ²	1,306.598
4	3.212/ b	Shtrese stabilizanti 10 cm	m ²	6,940
5	3.229/ 1	Shtrese binder 5 cm	m ²	5,205

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njësisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do të paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për t'u firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

ANETARET E NJESISE SE PROKURIMIT